



## Vaksinimi i përforsuar me një vaksinë mRNA (Pfizer/BioNTech, Moderna)

Vaksinat mRNA mbrojnë mirë nga Covid-19 të rënduar me shtrimin në spital. Por kjo mbrojtje e imunizimit bazë bie shpejt në rastin e varianteve të virusit aktual. Prandaj ne rekomandojmë gjithashtu një vaksinim të përforsuar për të gjithë personat nga mosha 12.

### Përse shërben një vaksinim i përforsuar?

Nëpërmjet vaksinimit të përforsuar sistemi imunitar do të kujtohet për mikrobin patogjen. Mbrojtja e vaksinimit kundër sëmundjeve të rënda shtohet dhe zgjatet përsëri.

Kjo është e rëndësishme për t'u ditur: Në rastin e varianteve të virusit aktual vaksinimi nuk mbron fare dhe të mbron vetëm për pak nga një infektim dhe një sëmundje e butë. Ju mund të merrni Covid-19 pavarësisht vaksinimit.

### Ku i rekomandohet vaksinimi përforsues?

Një vaksinim përtëritës rekomandohet për persona nga mosha 12 vjeç.

Rekomandimi vlen në veçanti për njerëzit, të cilët janë të rrezikuar veçanërisht nga koronavirusi.

- Personat mbi 65 vjeç
- Personat mbi 16 vjeç
- me sëmundje<sup>1</sup> kronike të caktuara
- gratë shtatzëna

### Kur duhet të bëhet vaksinimi i përforsuar?

Një vaksinim i përforsuar rekomandohet duke filluar 4 muaj pas imunizimit të përfunduar bazë me një vaksinë mRNA. Një imunizim bazë ka përfunduar pas

- dy dozave të vaksinimit të një vaccine mRNA; ose
- një infektimi të konfirmuar me koronavirus + një dozë vaksinimi të një vaccine mRNA në periudhë kohore të paktën 4 javë (pavarësisht nga rendi).

Edhe nëse ju jeni infektuar me koronavirus pas imunizimit bazë ne ju rekomandojmë vaksinimin e përforsuar. Një infektim sipas njohurive të reja nuk ofron asnjë mbrojtje të mjaftueshme nga një sëmundje e rëndë. Ju mund të vaksinoheni katër javë pas infektimit (duke marrë parasysh periudhën minimale prej 4 muajsh pas vaksinimit të fundit kundër Covid-19).

### Me cilën vaksinë bëhet vaksinimi përforsues?

Në parim nuk luan asnjë rol, se cila nga dy vaksinat e disponueshme përdoret.

Për personat nën 30 vjeç vlen si më poshtë:

Personave nga mosha 18 deri në 29 vjeç iu rekomandohet kryesisht vaksinimi përforsues me vaksinën e Pfizer/BioNTech.

Personave nga mosha 12 deri në 17 vjeç iu rekomandohet vaksinimi përtëritës me lëndën e vaksinimit Pfizer/BioNTech.

Kjo, sepse në raste shumë të rralla pothuajse pas vaksinimit kanë ndodhur pezmatime të muskulit të zemrës ose të perikardit. Ato janë vëzhguar disi më shpesh pas një vaksinimi me vaksinën Moderna sesa me vaksinën e Pfizer/BioNTech. Bëhet fjalë për një efekt anësor shumë të rrallë dhe mund të trajtohet mirë. Pezmatime të tilla shfaqen edhe pas një infektimi me koronavirus. Megjithatë në rastin e të dyja vaksinave mRNA vlen: Edhe te personat nën 30 vjeç mbizotëron përdorimi i vaksinimit kundër Covid-19 me reziqet e mundshme.

### Ku mund të vaksinohem?

Përgjegjëse për vaksinimin janë kantonet. Informohuni në faqen e internetit ose në linjën informuese të kantonit tuaj ([www.foph-coronavirus.ch/cantons](http://www.foph-coronavirus.ch/cantons)), ku mund të regjistroheni dhe të vaksinoheni. Ose pyesni mjeken tuaj, mjekun tuaj, farmacisten tuaj ose farmacistin tuaj.

### Për kë rekomandohet një vaksinim tjetër përforsues (pas një vaksinimi të parë përforsues të kryer me sukses tashmë)?

Aktualisht për të gjithë personat mbi 80 vjeç rekomandohet një vaksinim tjetër përforsues. Edhe personat me një sistem imunitar shumë të dobët (për shkak të sëmundjes ose medikamenteve) ne rekomandojmë një vaksinim tjetër përforsues – në këtë rast drejtohuni te mjekja juaj ose mjeku juaj.

Një vaksinim tjetër përforsues mund të bëhet 4 muaj pas vaksinimit të fundit. Ajo rrit përsëri mbrojtjen nëpërmjet vaksinimit nga një sëmundje e rëndë të paktën për një periudhë kohe të caktuar.

Jeni infektuar me koronavirus që nga vaksinimi i fundit? Meqë mbrojtja juaj nga sëmundja e rëndë nëpërmjet këtij infektimi nuk ka rritje thelbësore, ne ju rekomandojmë një vaksinim tjetër përforsues. Ju mund të vaksinoheni 4 javë pas infektimit (duke marrë parasysh periudhën minimale prej 4 muajsh pas vaksinimit të fundit kundër Covid-19).

**Informacionet e tjera për vaksinimin përforsues janë të njëjta si për imunizimin bazë dhe mund të lexohen në broshurën "Informacione të përgjithshme për vaksinimin kundër Covid-19 me një vaksinë mRNA".**

<sup>1</sup> Listën e hollësishme të sëmundjeve e gjeni te: *Kategoritë e personave veçanërisht të rrezikuar*